


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores Nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-1266/15, për z. Blerim Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ekziston konflikt interesi dhe gjendje të mos pajtueshmërisë në rastin e ushtrimit të funksionit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Koordinator i Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë, të paraparë sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Blerim Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Koordinator i Qeverisë të Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Shala, është trajtuar për situatë të mundshme të konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e njëkohësishëm të funksionit publik

si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Koordinator i Qeverisë të Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë.

Zyrtari i lartë z. Shala, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Shala është njoftuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhet.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në bazë të këtij Ligji pozita e Deputetit dhe Koordinatorit hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Pas analizimit të gjendjes dhe shqyrtimit të fakteve në dispozicion nuk kemi gjetë prova të mjaftueshme që vërtetojnë gjendjen e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nuk përmban dispozita kufizuese lidhur me çështjen e ushtrimit e funksioneve të lartcekura.

Zyrtari i lartë z. Shala, gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasysh obligimin për deklarimin rast për rast të interesave lidhur me një vendimmarrje të caktuar, neni 13 paragrafi (1,2,3) i Ligjit Nr.04/L-051, si dhe duhet ti përmbahet parimeve të veprimit dhe mos veprimit gjatë ushtrimit të funksionit publik të paraparë sipas nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit.

Ndërsa lidhur me dyshimet e ngritura për kufizim dhe papajtueshmëri të Deputetit në ushtrimin e funksionit publik të paraparë sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Agjencia Kundër Korrupsionit duke u bazuar në mandatin që ka dhe në kompetenca të parapara me Ligj, e konsideron veten jo kompetent për interpretimin e normave Kushtetuese dhe Ligjit Nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

Andaj konsiderojmë se është në përgjegjësinë e institucioneve kompetente vlerësimi i gjendjes së krijuar me rastin e emërimit të z. Blerim Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në rolin e Koordinatorit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

